


Sterilizimi i Pajisjeve të Ushqimit


Të gjitha pajisjet, të çfarëdolloji qofshin (si bie fjala shishet, thithat, pompat e gjirit), që përdoren për ushqimin e foshnjës qoftë me ushqim formule apo me qumësht gjiri duhet të mbahen patjetër të pastra. Kjo ndihmon për ta mbrojtur foshnjën nga infeksionet, sidomos nga parazitët e barkut që shkaktojnë diarre dhe të vjella.

Për këtë qëllim duhet që pajisjet të sterilizohen pasi të jenë larë mirë. Po ashtu të sterilizohen dhe mjetet që foshnja fut në gojë, si lugët, filxhanat, kavat dhe unazat për të kruajtur mishin e dhëmbëve. Kjo punë duhet bërë vazhdimisht deri sa foshnja mbush vitin.

Ka disa mënyra për sterilizimin e pajisjeve. Mund të përdoret:




tenxhere




sterilizues kimik

(që nuk është i mirë për sterilizimin e artikujve metalikë)




autoklavë me avull

Po ashtu mund të përdoret sterilizator me shishe për sobë me mikrovalë, por edhe kjo nuk është e mirë për artikuj metalikë apo për disa lloje artikujsh plastikë.




1) Të lahen mirë me ujë të nxehtë me sapun të gjitha shishet dhe enët e tjera duke përdorur furçë për shishet. Të fërkohen shishet nga brenda e nga jashtë për të hequr çdo gjurmë yndyre. Kujdes i vacantë duhet treguar me pastrimin e buzës.



2) Të përdoret një furçë e vogël thithash për të pastruar thithën nga brenda; ose thitha të kthehet nga e prapta e të lahet me ujë të nxehtë me sapun; në se përdoret kripë për larjen e kapës nga brenda e nga jashtë duhet që larja të jetë e plotë.




3) Të shpëlahen të gjitha gjërat para sterilizimit.



4) **Sterilizimi me zierje:**


Të vihen pajisjet në një tenxhere të madhe të mbushur me ujë. Në shishe e në thithë të mos mbetet asnjë fluskë ajri. Mbulohet tenxherja me kapak dhe lihet në zjarr deri sa të ziejë. Zierja të vazhdojë për 10 minuta. Kujdes mos shteret uji. Tenxherja të rrijë e mbuluar deri në çastin kur të nevojiten pajisjet.

Thithat dhe shishet të kontrollohen rregullisht për shenja dëmtimi. Shishet bëhen si të veshura ose marrin krisje me kalimin e kohës dhe thithat marrin rrudha e bëhen të qullëta – nëse keni dyshim, këto pajisje i hidhni.



5) **Për sterilizimin me kimikate:**

Tretësira përgatitet duke përdorur tableta ose lëng sipas udhëzimeve të fabrikës. Të vihen pajisjet në tretësirë gjithmonë duke pasur kujdes që në shishe ose në thitha të mos ketë fluska ajri. Rezervuari i sterilizatorit duhet të ketë një pjesë që i mban të gjitha pajisjet të zhytura në ujë – përndryshe duhet t'u vini përsipër një pjatë. Pajisjet duhet të rrinë në tretësirë për 30 minuta. Tretësira të përgatitet e freskët çdo 24 orë.



6) **Sterilizimi me autoklavë ose me mikrovalë bëhet sipas udhëzimeve të fabrikës.**

Gjithmonë të lahen duart para nxjerrjes së pajisjeve nga sterilizatori.

Kur përdoret sterilizues kimik, dhe nëse dëshironi që pajisjet t'i shpëlani para përdorimit, atëherë përdorni ujë të zier që është lënë të ftohet. Të mos përdoret ujë nga çezmja.